



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Datë:30.06.2025

Maturantët e Suharekës arrijnë 63% të kalueshmërisë në provimin shtetëror të Maturës 2025

Provimit të maturës shtetërore në vitin shkollor 2024/25, në afatin e qershorit iu nënshtruan 550 maturantë, nga komuna e Suharekës, i cili u realizua me datë 21.06.2025.

Testi sipas planifikimit u realizua në 3 objekte shkollore përkatësisht në 6qendra te testimi, (qendra 1- gjimnazi “ Jeta e re”, qendra 2-SHFMU “7 Marsi” , qendra 3 dhe qendra 4 në IAAP “ Skender Luarasi” dhe qendra 5 e 6 në IAAP “ Abdyl Ramaj”-Shirokë)

DKA në Suharekë ka pranuar rezultatet e Provimit të Maturës shtetërore dhe pas analizës që ka bërë ka nxerrë përqindjen e kalueshmërisë ku bazuar në këto rezultate del se në komunën e Suharekës kalueshmëria është **63%**. Krahasuar me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar rezulton se ka një rënie prej **1.19 %**.

Drejtori i DKA-së, Remzi Bajselmani u dëshiron suksesese në rrugëtimin për studime ndërsa ata që nuk arritën ta kalojnë provimin në këtë afat, u dëshiron shumë suksese në afatin tjetër me bindjen se me përpjekje do të arrijnë të realizojnë qëllimet e tyre